# Sistemi Faturimit dhe Arkëtimit Mobil

## 1. Hyrje

Qëllimi kryesor i zhvillimit të Sistemit të Billingut dhe versionit Mobil konsiston në plotësimin e kërkesave në mënyrën më të mirë të mundshme për çdo konsumator.

Ky sistem do të shërbenë për menaxhimin dhe monitorimin e procesit te faturimit Mobil , për kompanitë shpërndarëse të rrjetit të ujit dhe të mbeturinave . Sistemi është projektuar për të manaxhuar proçesin e hedhjes së leximeve, faturimeve dhe pagesave të detyrimeve.

Sistemi Billing dhe sistemi mobile do të sinkronizohen në mënyrë automatike me njëri tjetrin për të shkëmbyer të dhëna. Të dhënat do të kalojnë nga sistemi bazë Waterbill tek ai Mobile, gjithashtu të dhënat e regjistruar në Mobile do të kalojnë në sistemin bazë.

Sistemi do t'u vijë në ndihmë si inkasantëve ashtu dhe menaxherëve të kompanisë. Sistemi do të lehtësojë proçeset e punës për inkasantët dhe do të ndihmojë menaxherët duke ofruar monitorimin e veprimtarisë dhe detyrave të inkasantëve.

Arritja e këtij qëllimi i jep zgjidhje një numri të madh problematikash, midis tyre:

- Mirëmbatja dhe menaxhimi i marrëdhënies me konsumatorët.
- Caktimi dhe ndjekja e detyrave të të gjithë inkasantëve në terren etj.
- Menëaxhimi sa më mirë i klientëve kërkon njohuri për pozicionin gjeografik për secilin prej konsumatorëve, gjë e cila mund të merret me anë të përdorimit të sistemit.

Sistemi funksionon në Web, duke i lejuar menaxherëve dhe të gjithë përdoruesve të sistemi të aksesojnë informacionin nga çdo vendodhje, në mënyrë të menjëhershme, nëpërmjet një kompjuteri, tableti, telefoni i cili ka internet.

Të drejtat dhe rolet e çdo përdoruesi mund të përcaktohen nga administratori:

- Në nivel modulesh,
- Në nivel ambjentesh dhe entitete.

Secili përdorues në mënyrë individuale do të këtë të drejtë për të parë, shtuar, modifikuar apo fshirë vetëm nëse i janë përcaktuar të drejta për të kryer këto veprime.

### 1.1 Benefitet e përdorimit web

- Informacion i aksesueshëm lehtësisht online.
- Siguri më e lartë në menaxhimin e informacionit
- Përshpejtim i procesit të vendimmarrjes
- Aplikacion i aksesueshem ne pajisje mobile/desktop
- Integrim me aplikacione te tjera
- Raportime te organizuara sipas nevojave
- Automatizim i proceseve dhe detyrave te realizuara

### 1.2 Benefitet e sistemit Mobile

- Koordinim më i mirë ndërmjet departamenteve
- Përmirësim i rezultateve
- Reduktim i kostove operative
- Ulje e gabimeve njerëzore
- Menaxhim efiçient i inkasantëve
- Përcaktim i shpejtë i detyrave dhe veprimeve
- Koordinim me i mirë i detyrave të inkasantëve në terren
- Organizim i planit të punës ditor
- Flëksibilitet në menaxhimin e detyrave.

Hyrja në sistem nga ana e punonjësve do të bëhet në mënyrë të sigurtë. Secili punonjës do të ketë të drejta vetëm në atë pjesë të të dhënave që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrës nga ky punonjës.

Aplikacioni mobile përmbanë të gjitha proceset e nevojshme që do të kryhen nga inkasantët.

Qëllimi kryesor është leximi dhe gjenerimi i faturës dhe Arketimi  për çdo konsumator të inkasantit.

Hyrja në sistem do të bëhet me anë të një kombinimi përdorues/fjalëkalim.
Çdo inkasant do të mund të shohë vetëm konsumatorët e tij.
Gjithashtu, secili punonjës do të ketë të drejta vetëm në atë pjesë të të dhënave që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrës prej tij.

Sistemi mobile do të ofrojë mundësinë e punës **online dhe offline**.

Gjatë kohës që sistemi do të punojë **online**, ai do të shkëmbejë të dhëna në kohë reale me sistemin waterbill.

Në rastin e punës **offline**, sistemi mobile në pajisjet mobile do të regjistrojë të dhëna në databasen e vetë lokale, dhe në momentin që do të jetë online, do të shkëmbejë të dhëna automatikisht me sistemin bazë.

Më poshtë do të përshkruajmë në mënyrë më të detajuar funksionet kryesore që ofron ky sistem.

## 1.3 Modulet

Mobile Waterbilli do te permbaje 7 menu kryesore.




Admin Dashboard:
- Moduli CRM
- Menaxhimi i punetoreve(sistemi i autorizimit, modifikimi i pozitave, caktimi i paisjeve)
- Listimi i konsumatoreve, caktimi i kordinatave te konsumatoreve
- Caktimi i takimeve mes puntoreve dhe konsumatoreve
- Kontrollimi ne kohe reale i lokacioni te punetoreve
- Dergesa me email ne momentin qe ka ndonje ankese te re nga konsumatoret
- Sistemi i notifikimeve ne Admin dashboard

Mobile:
- Moduli CRM
- Moduli i faturimit
- Moduli i konsumatoreve
- Moduli i arketimeve

Ne Alpha Web Mobile është e  mundur që inkasantët të rregjistrojnë leximet, të i printojnë faturat e konsumatorëve, të rexhistrojn Arketimet, etj.
Ky aplikacion është  i organizuar ne menu. Cdo menu do te kete ikonen e saj perkatese.
Aplikacioni ne mobile, do te integrohet me Waterbillin per marrjen e te dhenave te nevojshme dhe dergimin e rregjistrimeve.

## 2. Administrimi / Dashboard

### 2.1 Moduli i Administrimit / Dashboard

Moduli i administrimit të përdoruesve përfshin një varg funksionesh që shërbejnë për krijimin dhe përcaktimin e te drejtave që do të kenë përdoruesit në sistem. Moduli i administrimit shërben gjithashtu për kontrollin dhe monitorimin e veprimeve nga përdoruesit e sistemit. Moduli i administrimit përfshin:






## 2.2 Krijimin e roleve të përdoruesve në sistemin mobile

- Rolet e përdoruesve janë grupe të drejtash që përcaktohen në nivel ambjenti të sistemit. Për çdo menu në sistem, përcaktohet se cfarë të drejtash ka roli. Të drejtat që mund të përcaktohen janë:
  - Të drejta në menu
  - Të drejta shtimi
  - Modifikimi
  - Fshirje
  - Të drejta për të parë vetëm dokumentat e tij apo të gjithë veprimet.

Në sistem mund të krijohen një numër i pakufizuar rolesh. Ato mund të krijohen lehtësisht nga administratori. Një rol mund të modifikohet apo të deaktivizohet.




## 2.3 Krijimin e përdoruesve të sistemit mobile




Në sistem krijohen përdoruesit që do të shfrytëzojnë sistemin mobile. Për  përdorues përcaktohen të dhënat e tij si :

- Emër Mbiemër
- Përdoruesi me të cilin do të hyjë në sistem.
- Fjalëkalimi
- Të dhënat e kontaktit si Email, Tel, Adresa.
- Roli që ka përdoruesi. Për një përdorues mund të përcaktohen disa role njëherësh, në varësi të të drejtave që duhet të ketë.

Një përdorues mund të modifikohet, të fshihet nëse nuk ka realizuar asnjë veprim në sistem apo të deaktivizohet.




## 2.4 Krijimin e grupeve të autorizimit

Grupet e autorizimit shërbejnë për të limituar të drejtat në të dhënat e sistemit. Për shembull, në listën e konsumatorëve, një inkasant do të ketë të drejta të shohë vetëm listën e konsumatorëve që ai është përgjegjës. Kjo realizohet duke krijuar një grup autorizimi për çdo inkasant dhe duke ia caktuar çdo konsumatori grupin e caktuar. Çdo inkasant do të lidhet me grupin e autorizimit të tij, dhe në këtë mënyrë do të mund të shohë vetëm konsumatorët e tij.

## 2.5 Moduli CRM

Ky modul shërben për menaxhimin dhe kontrollin sa më efektiv të inkasantëve dhe operatorëve në terren. Moduli do të shërbejë për përcaktimin e detyrave dhe proçeseve që duhet të kryejnë inkasantët në bazë ditore. Gjithashtu manaxherët, duke përdorur këtë modul mund të kontrollojnë historikun e veprimtarisë së kryer në mobile nga inkasantët.

Ky modul përfshin funksionet e mëposhtme:

- Marrja e listës së inkasantëve nga sistemi i faturimit/ ose krijimi manual i tyre në modul.
- Krijimi i detyrave ose proçeseve rutinë.
- Krijimi i Routit të inkasantëve.
- Monitorimi i aktiviteteve të kryera nga inkasantët me anë të historikut.
- Menaxherët mund të shohin në programin bazë gjithë routin e përcaktuar për çdo inkasant.
- Dergimi i urdhereses nga Dashbordi tek Inkasanti për ndoj detyre te caktuar,,,text ( pop up ) ne Mobile , dhe anasjelltas nga Inkasanti tek menaxheri ne Dashboard text ( pop up )ne PC.
- Harta nga Dashbordi te lidhet me nje TV me ekran ma te madh , mos te pengohet puna ne PC
- Menagjeri përcakton Routin e Inkasanteve ,, Arkatarve apo Shoferve te Kamionave nëse pajisen me sistem.
- Kontrollon levizjes e inkasantave dhe Kamioneve nëse janë të pajisur me sistem.
- Shikon vendodhjen dhe kohën e qëndrimit të Inkasantit nëse na ofron saktesin harta.
- Jep mesazhe direkte të cilat dalin ne paisjen e Inkasanteve ,, Arkatarve apo Shoferve te Kamionave ( nëse pajisen me sistem ).

Për çdo aktivitet apo detyrë e përcakuar për inkasantin do të tregohet statusi i realizimit.

Një mënyrë monitorimi është gjithashtu historiku i aktiviteteve të kryera nga inkasantët. Për çdo konsumator shfaqet historiku i të gjitha vizitave dhe veprimeve të kryera nga ana e inkasantit.

Moduli CRM përfshin disa funksione, në momentin që do të klikohet do të hapet Lista e perdoruesve me te cilet do të ndahet mesazhi. Kur përdoruesi klikon për të ndarë mesazhin më poshtë do të shfaqen: Koha dhe Datat e njoftimit , lloji dhe përshkrimi i njoftimit, duke u shfaqur Pranuesi dhe Derguesi , Njoftimet mund te dergohen ne Grup apo individual. Njofimet mund te paraprogramohen dhe jane te pa editushme me konfirmimin e pranimit të tyre dhe historiku do te mbetet.






CRM në mobile do të jetë e mundur të shfaqen: Koha dhe Datat e njoftimit , lloji dhe përshkrimi i njoftimit, duke u shfaqur Pranuesi dhe Derguesi .
Njoftimet nga Mobile mund te dergohen ne Grup apo individual.
Njofimet mund te paraprogramohen nga administrata  dhe jane te pa editushme me konfirmimin dhe pranimin  e tyre dhe historiku do te mbetet.







Ambjenti do të shërbejë për krijimin e shërbimeve dhe detyrave në CRM.

## 2.6 Route

Route luan rolin e një axhende pune për inkasantët në terren. Përgjegjësi përcakton për çdo datë një listë me konsumatorë apo rrugë që inkasanti në terren duhet të vizitojë. Route bazë përcaktohet nga manaxheri në sistem WaterBill Dashbiard dhe u shfaqet në aplikacionin Mobile inskastantëve sipas Routet të caktuar për secilin prej tyre.









Monitorimi i inkasantëve do të bëhet gjithashtu me anë të monitorimit në hartë të secilit inkasant. Pasi zgjidhet agjenti mund të shikohet harta e lëvizjes së tij. Nëse klikohet në pikën ku ai ka qenë, mund të shikohet dhe kohëzgjatja e qëndrimit të tij. Harta mund të filtrohet sipas periudhave të ndryshme.

## 2.7 Historiku i veprimeve

Për çdo konsumator shfaqet historiku i të gjitha vizitave dhe veprimeve të kryera nga ana e inkasantit. Historiku i veprimeve mund të shikohet duke zgjedhur periudhën e dëshiruar, inkasantin ose konsumatorin.

Historiku i veprimeve do të shikohet në hartë. Do të ngarkohet harta sëbashku me opsionin Satellite. Në hartë do të ngarkohen veprimet e të gjithë përdoruesve në mobile. Për cdo përdorues me route do të ngarkohen kosumatorët e takuar në atë ditë. Cdo takim do të ketë një numër rendor sipas radhës së kryerjes së tij. Numërimi do të jetë ditor dhe për cdo përdorues. Koordinatat e konsumatorit do të merren nga takimi i realizuar në mobile.



## 3. Raporte

### 3.1. Klientët e Pafaturuar

Ky raport afishon konsumatorët e pa Faturuar sipas muajit të grupuar, sipas inkasantëve, Zones , rrugës dhe Tipit. Informacioni që mbart mund të printohet në formate të ndryshme . Ky raport jep gjithashtu edhe një mesatare sipas inkasantëve dhe në total për konsumatorët.






## 3.2. Aktëtimet

Ky raport afishon konsumatorët nga të cilët është Arketuar në teren nga Paisja Mobile sipas muajit të grupuar, sipas inkasantëve, Zones , Vitit dhe Tipit. Informacioni që mbart mund të printohet në formate të ndryshme .




## 3.3. Faturat

Ky raport afishon konsumatorët tek të cilët është Faturuar në teren nga paisja Mobile sipas muajit të grupuar, sipas inkasantëve, Zones , Vitit dhe Tipit. Informacioni që mbart mund të printohet në formate të ndryshme .



## 3.4. Klientët Draft

Ky raport afishon konsumatorët të cilët janë rexhistruar në teren nga paisja Mobile sipas Zones dhe Rruges. Informacioni që mbart mund të printohet në formate të ndryshme .




## 3.5. Klientët Drafta

Ky raport afishon shënimet, Komentet e rexhistruara nga inkasantët në teren nga paisja Mobile nga më të ndryshmet
.



## 4. Aplikacioni Mobile

Aplikacioni mobile do të përmbajë të gjithë proceset e nevojshme që do të kryhen nga inkasantët. Qëllimi kryesor është leximi dhe gjenerimi i faturës dhe Arketimi për çdo konsumator të inkasantit.

Hyrja në sistem do të bëhet me anë të një kombinimi përdorues/fjalëkalim. Çdo inkasant do të mund të shohë vetëm konsumatorët e tij. Gjithashtu, secili punonjës do të ketë të drejta vetëm në atë pjesë të të dhënave që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrës prej tij.

Sistemi mobile do të ofrojë mundësinë e punës online dhe offline. Gjatë kohës që sistemi do të punojë online, ai do të shkëmbejë të dhëna në kohë reale me sistemin waterbill.






### 4.1. Moduli CRM

Për çdo aktivitet apo detyrë e përcakuar për inkasantin do të tregohet në mobie si dhe statusi i realizimit.

Një mënyrë monitorimi është gjithashtu historiku i aktiviteteve të kryera nga inkasantët. Për çdo konsumator shfaqet historiku i të gjitha vizitave dhe veprimeve të kryera nga ana e inkasantit.

Moduli CRM përfshin disa funksione, në momentin që do të klikohet do të hapet Lista e perdoruesve me te cilet do të ndahet mesazhi. Kur përdoruesi klikon për të ndarë mesazhin më poshtë do të shfaqen: Koha dhe Datat e njoftimit , lloji dhe përshkrimi i njoftimit, duke u shfaqur Pranuesi dhe Derguesi , Njoftimet mund te dergohen ne Grup apo individual. Njofimet mund te paraprogramohen dhe jane te pa editushme me konfirmimin e pranimit të tyre dhe historiku do te mbetet.

#### Detyra




Ambjenti shërbenë për krijimin e shërbimeve dhe detyrave në CRM.

Ambjenti do të jetë i organizuar në disa tabe: Të përgjithshme ku shfaqet lista e detyrave të krijuara në sistem dhe përshkrimi i detyrës.

Detyra do të jetë për CRM, pra opsione që mund të zgjedhi inkasanti në mobile .

a. Një form e CRM në të cilin mund te komunikojn inkasantet ,,,Shoferet duke ndertu grupe apo në tërsi....( koncepti i taksive ) ,,por ketu në form të shkruar për ta ruajtur historin.

b. Problemet teknike parakonfigurohen dhe chekohen në momentin e veprimit të inkasantit ,, të cilat lidhen dhe ruhen se bashku me veprimin, me Foto apo Text.

c. Paracaktohen kontaktet nga Inkasanti > Menagjeri , si dhe Menagjeri > Inkasant.

d. Konsumator të Ri hapen direkt nga Inkasanti dhe ruhen në Sistem me status Draft , mandej verifikohen dhe plotesohen me shenime shtesë nga Menagjeri apo stafi tjeter Kompetent.

## 4.2. Lista e Konsumatrove

- **Konsumatorë**: shfaqen të gjithë konsumatorët e caktuar në Route (në Waterbill ), për këtë përdorues, në këtë datë. Të dhënat që do të shfaqen do të jenë: Kodi – Përshkrimi (Rruga).
- **Rrugë**: Nëse për këtë datë, për këtë përdorues është caktuar një rrugë, në mobile do të shfaqen të gjithë konsumatorët e lidhur me këtë rrugë, që janë aktiv dhe që kanë të zgjedhur si inkasant përdoruesin e loguar. Nëse përdoruesi i loguar nuk është me status Inkasant, do të shfaqen të gjithë konsumatorët e lidhur me këtë rrugë.




Përdoruesi do të ketë mundësi te filtroje sipas:

- Kod konsumatori
- Kod i vjetër
- Përshkrimi
- Adresa
- Numri i ujëmatësit
- Numri i vulës
- Kategorisë

Gjithashtu përdoruesi mund të ndryshojë renditjen e takimeve, duke rrëshqitur takimin dhe pozicionuar në radhën e kërkuar.

***Shenim***: *Për konsumatorët të cilët nuk kanë të vendosura koordinata, nuk do të shfaqen në hartë megjithëse janë të përcaktuar në Route-in e Inkasantit për t'u vizituar. Këta konsumatorë do të shfaqen vetëm tek kalendari.*

## 1. Rout i inkasantit dhe Lokacioni




a. Me viziten e pare behet Leximi i Kordinatave te konsumatorit dhe paraqitja e tij ne Hart ne Dashbord automatikisht e cila mbetet statike me ngjyre të Kuqe.

b. Vizita e radhes e ndrron statusin ne te gjelbert ne momentin qe perputhen kordinatat gjat vizites, dmth Inkasanti detyrohet të e vizitoj konsumatorin sepse në të kundërtën nuk ndryshon statusi.

c. Resetimi i maps behet automatikisht me date 01/ te muajit vijues dhe dalin konsumator me status Kuq, pasi të mbyllet cikli i veprimeve mujore.

d. Ne hart duhet të dallojn simbolet e vendodhjes së konsumatorve dhe Inkasantave apo Shoferve të Kamioneve.

e. Rout tek Inkasanti, Arkatri apo Kamioni shikojn Harten nese eshte  percaktuar nga Menagjeri.

f. Vizitat jane te obligura sepse vetem ateher sistemi e aprovon si të mbyllur detyren dhe ciklin e veprimeve ( Psh: Faturimin, Zbrazjen, apo zgjidhjen teknike tek konsumatori ,,etj ).

g. Çdo inkasant do të shohë në sistemin mobile listën e konsumatorëve të tij që duhet të vizitojë në bazë ditore.

h. Për konsumatorët që nuk kanë një vendndodhje të përcaktuar, inkasanti mund të shtojë vendndodhjen duke shfrytëzuar vendndodhjen e tij me anë të GPS.



- **Sinkronizo :** Do të behet sinkronizimi me Waterbill

Në momentin që përdoruesi klikon një konsumator të caktuar do të merren dhe ruhen:

Në këtë moment do të hapet ambjenti i regjistrimit të leximit. Konsumatori mund të jetë:

## 4.3. Konsumator Draft

Inkasanti në përmjet modulit mund të cel konsumator të ri në teren duke e plotësuar me informacione dhe ne koh reale paraqitet në Billing për plotesim me informacione shtes dhe për ta ber aktiv .




- **Individual:** Nëse konsumatori është i lidhur me një ujësjellës individual, do të hapë ambjentin e rregjistrimit te leximit individua dhe do te paraqitet si draft.
- **Kolektiv:** Në qoftë së ujëmatësi i lidhur me konsumatorin është kolektiv, do të hapet ambjenti i regjistrimit të leximit kolektiv.

Kushtet që duhet të plotësojë janë:

- Konsumatori ka datë fillimi më të vogël se sot dhe datë mbarimi më të madhe se sot (ose date mbarimi bosh)
- Konsumatori ka te rregjistruar lexim për periudhen e fundit të kycur.

Fushat që do të shfaqen janë si ne foto.

### 4.4. Leximet e Konsumatorve

**Konsumatori**: Do të hapet kartela e konsumatorit. Inkasanti mund të shohi të dhënat e konsumatorit aktual, ose mund të çeli një të ri. Pasi të ketë përfunduar në këtë ambjent, do të kalojë përsëri me back tek ambjenti i faturimit.

**Cek**: Nëse vlera e leximit është e konfirmuar tek do të kalojë tek konsumatori I radhës. Nëse nuk është e konfirmuar do të shfaqi pop-up dhe pas konfirmimit do të kalojë tek konsumatori i radhës. Në këtë moment do të quhet e mbyllur vizita tek konsumatori dhe do të kalkulohet koha totale e vizitës. Gjithashtu do të merret dhe koordinata e përfundimit të vizitës.




**Kujdes:** Nëse në route janë dy ose më shumë konsumatorë që janë të lidhur me të njëjtin ujëmatës kolektiv, kur të hapet tek konsumatori i dytë vlera e leximit do të jetë e plotësuar. Gjithashtu nëse është gjeneruar faturë për këtë muaj, kjo vlerë nuk mund të modifikohet më. Kjo vlen dhe për leximet individuale. Gjithashtu nëse është gjeneruar faturë për leximin kolektiv, nuk do të modifikohet as leximi për konsumatorët e përjashtuar nga ky ujëmatës.

## 4.5. Gjenerimi i Faturës mujore

Ambjenti i gjenerimit të faturës mujore do të shërbejë për gjenerimin mujor të faturave për të gjithë konsumatorët. Gjenerimi mund të bëhet për të gjithë konsumatorët ose i veçantë për çdo konsumator, zonë, tip, nëntip etj.

Për të gjeneruar faturën, përdoruesi do të klikojë butonin Gjenero faturë.
Do të bëhen kalkulimet dhe do të gjenerohet fatura për muajin për të cilin janë hedhur leximet. Llogaritjet në gjenerimin e faturës do të bëhen njëlloj si në Waterbill. Faturat do të sinkronizohen në Waterbill dhe do të shfaqen tek ambjenti Faturat e shitjes. Për konsumatorët të cilëve iu është gjeneruar faturë në Mobile, nuk mund të modifikohet leximi i muajit as në Mobile, as në Waterbill Web. Gjithashtu nuk mund te rigjenerohet fatura.







**Kontrollet :**

- Nqs për këtë muaj nuk ka lexime, nuk do të gjenerohet fatura.
- Nuk mund të rigjenerohet faturë.
- Do të kontrollohet nqs një konsumator është pezull gjatë periudhës së faturimit ose jo
- Duhet të kontrollohet periudha e faturimit të klasës së lidhur me konsumatorët.

### 4.6. Inkasanti / Faturimi

- Leximi i Kontajnerave dhe kalkulimi i sasis së hargjuar në kohë reale dhe tek Konsumatori.
- Dergimi i fatures me Email per ata konsumator qe jane te konfiguruar,
- Sistemi funksionon me status Online dhe Offline.



## 4.7. Arkëtimet

Në ambjentin e arkëtimeve mund të regjistrohen arkëtimet analitike për çdo faturë ose përmbledhës për totalin e detyrimit që ka konsumatori.

Në mobile do të mund të regjistrohen arkëtimet të cilat inkasantët do t'i realizojnë në terren.

Ambjenti do të jetë i organizuar në dy menu: Arkëtime: Lista dhe E Re. Të gjithë dokumentat e regjistruara do të shfaqen tek ambjenti i Listës së Dokumentave.

Përdoruesi do të ketë mundësi për të bërë këto veprime:




**Konsumatori** – Në këtë ambjent do të mund të zgjidhet konsumatori për të cilin po realizohet Arkëtimi. Në momentin që klikohet mbi këtë fushë, do të shfaqet një ambjent i ri ku do të listohen të gjithë konsumatorët. Pamja do të jetë si më poshtë:

Kontrollet :

- Për cdo Arketim e detyrushme është të jepet numri telefonit të konsumatorit , me qëllim konfirmimi dhe njoftimi të vlerës së pageses me nje SMS.
- Siguria e Arketimeve është se në kohë reale , ne momentin që inkasanti e përfundon një Arketim , automatikisht sistemi ja dergon Konsumatorit një SMS me vlerën e Paguar , i cili veprim nuk mund të modifikohet nga Inkasanti dhe i cili regjistrohet në Sistem .
- Menagjeri ne Dashboarb gjithmon mund ta konsultoj gjendjen e Arketimeve per Inkasant dhe nxjerr raport për dorzimin e shumës së arketimit .




- Default tek lista e kosumatorëve do të shfaqen: Kodi dhe Përshkrimi i konsumatorit
- Do të shfaqen vetëm konsumatorët që i përkasin këtij inkasanti

Pasi te ruhet dokumenti, do te shfaqet tek lista e Arketimeve.

- Tek menuja kryesore, keto dokumenta do te mund te sinkronizohen.
- Pasi te kalojne ne Waterbill Web , do te prekin detyrimin e klientit dhe do te shfaqen tek Lista e Pagesave.
- Pasi te ruhen dokumentat nuk do te mund te modifikohen me nga pajisja mobile

## 4.8. Raporti i arkëtimeve

Në mobile do të mund të printohet një raport nga inkasantët në lidhje totalin e arkëtimeve të bëra gjatë ditës. Raporti mund te jetë i grupuar sipas klasave te konsumatorëve. Raporti do të jetë në formën e tabelës dhe default do të tregojë arkëtimet të ditës aktuale.

Raportii Arkatarit ne Mobile



Raport arketari nga POS

Operator: Administrator
Data e fillimit: 06.10.2022 11:19:38
Data e fundit: 12.10.2022 17:20:17

Raport i arkes

| | |
|---|---|
| Total: | 0.00 |
| Shitje | |
| Cash | 74.15 |
| POS - RBKO | 132.90 |
| POS - PCB | 61.31 |
| POS - TEB | 23.60 |
| Nen Total: | |
| Shuma progresive | 291.96 |
| Para ne dore | 74.15 |

Data dhe ora:16.10.2022 09:26:20

Chart




**Verifikimi dhe Konfirmimi**

a. Siguria e Arketimeve është se në kohë reale , ne momentin që inkasanti e përfundon një Arketim , automatikisht sistemi ja dergon Konsumatorit një SMS me vlerën e Paguar , i cili veprim nuk mund të modifikohet nga Inkasanti dhe i cili regjistrohet në Sistem .
b. Menagjeri ne Dashboarb gjithmon mund ta konsultoj gjendjen e Arketimeve per Inkasant dhe nxjerr raport për dorzimin e shumës së arketimit .

## 4.9. Raporte

### Për inksant - Mobile

c. Te forma Konfiguracione dhe informacione te nevojshme Standarte, tek cdo veprim apo Modul lart me dal nje grafik...psh:
d. Nese jemi te Faturat nje chart me dal me numer Fatura total ose % dhe te perfunduara,
e. Arketime nje chart sa % eshte permbush plani,,etj
f. Zbrazje te Kontajnerave
g. Menyrat e Pagesave te perfshihen dhe duhet te reflektojn ne Dashboard per Inkasant ,
h. Ndërsa ne Mobil vetem menyrat e pagesave dhe nje Raport per mbylljen e Arkes.

### Forma e Dashboardit qfar perfshin:

i. Përveq pjesës standarte për module dhe konfigurimeve në dashboard përfshihen:
j. Numirn e kosumatorve,
k. Numrin e faturave totale
   - Ditore dhe ne vlere si dhe sipas inkasanteve,
l. Numrin e Arketimeve total dhe sipas inkasanateve,
   - Arketime nje chart sa % eshte permbush plani,,etj
m. Numrin e Vizitave me Bazë Ditore dhe ne Total
n. Numrin e konsumatorve të Ri
   - Nese mund te ndahen edhe me zona ,,,lagje apo rrug etj

**Te gjitha keto edhe me Chart**

## 4.10. Model Faturat



Hidromorava Gjilan

KompaniaRajonale e Ujësjellësit
**KRU Hidromorava Sh.a**
VllezëritGërvallap.n , 60000 Gjilan
Phone: +381 0280 – 326 980,
Mobil: +377 44 983 071

NRB: 70433937 ,NRF: 600294160

FATURA – RAČUN – INVOICE

| | |
|---|---|
| Periudha e Fakturimit: Period faktur. | Tetor , 2014 |
| Nr. Faktures - Br. Računa | 207288 |
| Dt. Fakturës - Dt. Računa | 31 / 10 / 2014 |
| Data e leximit paraprake / aktuale.: | 31 / 10 / 2014 |
| Emri i Konsumat Ime Potros. | ADEM SADIKU |
| Adresa: | Zona: 16 , Rruga: KB. 32/I, Banesa / Pall: 5672, Dega: Gjilan |
| Nr. Fiskal / ID | Nr. Fiskal apo Nr.Letemjoftimit per persona fizik |
| Nr.Ujmatësit / Nr . i Pllombes : | 15472 |
| Nr. Konsumat. – Br. Potros. | 12764 |
| Numri i Vjetër: | 5672 |
| Inkasant: 12 Kategoria: | Shpëpiak |

| Leximi M3 | T | Uji | Kanal. |
|---|---|---|---|
| Gjendja e tanishme Sadašnje stanje | 1 | 2980 | 2980 |
| Gjendja Paraprake Prethodno stanje | 1 | 2954 | 2954 |
| Konsumi - Potrošnja : | | 26 m3 | 26 m3 |

| Kalkulimi - € | Sasia | Çmim | Tvsh | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Uji | 26 | 0.33 | 1.35 | 9.77 |
| Kanalizimi | 26 | 0.08 | 0.33 | 2.37 |
| Tarifa Fikse | | 1.00 | 0.16 | 1.16 |
| Shërb. tjera | | | 0 | 0 |
| | | Shumat | 1.84 | 13.30 |

| | |
|---|---|
| Vlera e Fakturës / Ukupan račun: | 13.30 € |
| Borxhi Riprogram: | 0.00 € |
| Totali për Pagesë / Za plačanje: | 13.30 € |
| Borxhi i papaguar / Neplačeni dug. | 296.06 € |
| Borxhi i përgjithsh. / Ukupan dug : | 309.36 € |
| Afati i Pagesës / Rok Uplate: | 20 Dite |

Detajet Shikoni Mbrapa – Upustva na poledjini →



Hidromorava Gjilan

KompaniaRajonale e Ujësjellësit
**KRU HidromoravaSh.a**
VllezëritGërvallap.n , 60000 Gjilan
Phone: +381 0280 – 326 980,
Mobil: +377 44 983 071
NRB: 70433937 ,NRF: 600294160

DËFTESË E PAGESËS
PRIZNANICA / CASH RECEIPT

| | |
|---|---|
| Vendi i Pagesës : | Arka Qendrore |
| Inkasanti: | 1 |
| Nr Pagesës : | 207288 |
| Data Pagesës : | 31 / 10 / 2014 |

**Arketuar nga :**

| | |
|---|---|
| Emri i Konsumat: | ADEM SADIKU |
| Adresa: | Zona: 16 , Rruga: KB. 32/I, Banesa / Pall: 5672, Dega: Gjilan |
| Nr.Ujmatësit: | 15472 |
| Nr. Konsumatorit : | 12764 |
| Inkasanti: 12 Kategoria: | Shpëpiak |

**Shuma e Paguar** **13.30 €**

**Vërejtje** : Dëftesa nuk është e detyrueshme të Vuloset sepse është nxjerr nga sistemi mobile.

Modelet e Faturave Mobile janë plotesishtë të editushme në aspektin e dizajnit për fushen e Menaxhimit të Mbeturinave dhe Menaxhimit Ujit.

### 4.11. Sinkronizimi:

Faturat do të sinkronizohen në Waterbill Web dhe do të shfaqen tek ambjenti Faturat e shitjes. Ne momentin kur vlerat e rregjistruara në mobile do te dergohen ne Waterbill (sinkronizohen), do te behet kontrolli ne qofte se periudha e faturimit në Mobile është e njejte me periudhen aktive ne Waterbill Web dhe nqs për këtë periudhë për këtë konsumator ka fatura të tjera

- Periudha e ndryshme ose Fature e regjistruar në Waterbill për këtë klient - Ne qofte se periudha eshte e ndryshme, keto fatura do te shkruhen ne nje tabele te vecante dhe do te mund te shikohen ne nje raport te vecante ne ambjentin e Raporteve, ne Waterbill. Te gjithe dokumentat ne mobile, qe kane periudhe me te vogel se periudha active ne Waterbill, do te fshihen nga mobile. Pra ne mobile useri do te shikoje vetem dokumentat e periudhes aktive.
- Periudha e njejte – Ne qofte se periudha eshte e njejte, faturat e rregjistruara ne mobile, do te shfaqen tek ambjenti i Faturavë ne Alpha Waterbill me status Gjeneruar Po

